

**AKT – THEMELIMI
(KONTRATË)
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR**

“XH&D COMPANY” SH.P.K

Unë, **Suela Gërdoçi**, e bija e Fadil-it e dtl.04.10.1975, lindur në Shkodër dhe banues në Rr.: Hudo Beg Sokoli, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID pas) Nr: 036721746, Nr.Personal H56004073C lëshuar më 11.12.2020, kam vendosur:

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë ekonomike e emërtuar **“XH&D COMPANY” SH.P.K** me ortak të vetëm Znj. Suela Gërdoçi

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themëlor.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Shkodër: Zona Industriale , Rruga Cerciz Topulli ,nr pasurie 14/126 Zona Kadastrale 8593 . Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filial, përfaqësi, degë,si dhe ti suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 200.000 lekë dyqindmijë), i ndara me 1(nje) kuote ,kapital i cili është i formuar tërësisht nga ortaku i vetëm themelues i saj,

Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku. Rritja e kapitalit të ortakut nuk është e kufizuar.

Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë shlyer dhe nënshkruar totalisht nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 8

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë:

- Hapje rrobaqepsie, prodhim veshje te ndryshme, sherbime ne fushën e rrobaqepësisë me linjea fason vendase dhe të huaja.
- Tregtim i tekstileve, metrazheve dhe konfeksioneve me shumicë dhe pakicë, import dhe eksportimi i tyre, shërbime instalimesh dhe mirmbajtje të makinerive dhe paisjeve të ndryshme, pjesë këmbimi, import dhe eksport dhënie me qera e tyre, automatizimi i makinerive për procesim industriale.
- Aktkivitet të konsulences teknike në fushën e prodhimit dhe tregtimit të konfeksioneve.

Neni 9

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 (Kodit të Punës), si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10

Ortaku i vetëm nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës dhe merr përsiper të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i vetëm themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në nivelin e kapitalit të investuar në Shoqëri.

Neni 12

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë percaktuar dhe inicialet e emertimit të saj.

Neni 14

Organet e shoqërisë **“XH&D COMPANY” sh.p.k** janë :

Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë znj. Suela Gërdoçi.

Modalitete për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe statute i shoqërisë, ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit”

Ky akt – Themelim është perpiluar në katër kopje me vlere të njëjtë me origjinalin.

Datë, 06.06.2023

THEMELUES :

Suela Gërdoçi

